



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:145277

Datë: 15.10.2024

Numri i dokumentit: 06301064

C.nr.104/22

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gerdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësës V. R. nga fshati..., Komuna e Dragashit të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqeria e Avokateve “K. &AS. L.L.C” nga Prishtina, Rr. “Bl. D. e K.”, Ul. C-..., 2/.. hyrja 1., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, me bazë juridike kompensimin e shujtave ditore gjatë punës, vlera e kontestit 1,000.00 €, jashtë shqyrtimi, me dt. 15.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të padëgjueshmërisë/ mosbindjes –

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësës V. R. nga fshati..., Komuna e Dragashit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Dragash, që paditësës V. R. nga fshati..., Komuna e Dragashit, në emër të kompensimit të shujtave gjatë punës për ditët e pranisë në punë për 52 ditë pune nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, duke llogaritur prej dates 01.06.2021 deri me datën 31.12.2021, **t’ia paguajë paditësës shumën e përgjithshme prej 104.00 € (njëqind e katër euro)**, me kamat ligjore duke llogaritur në lartësi 8%, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që paditësës t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 98.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësja V. R. nga fshati..., Komuna e Dragashit, përmes përfaqësuesit të autorizuar pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi me 30.06.2022, kundër të paditurës Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale në Dragash, për kompensimin e shpenzimit të ushqimit gjatë ditës (shujtave ditore), të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 09.09.2024, **ku çështjen e ka paraqitur si në vijim:**

Paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët (tutje: SHFMU) “Sh. Sh.” në Ll., Komuna e Dragashit në pozitën e Arsimitarës klasore që nga data 03.09.2012 e deri tani. Tutje, ka theksuar se e paditura Komuna e Dragashit përkundër obligimeve dhe të drejtat të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017

dhe 22.01.2021, konform dispozitave të nenit 35 pika 7 e kësaj marrëveshjeje, nuk ka bërë kompensimin e shujtave ditore dhe atë nga 2 euro për ditët e pranisë në punë, duke propozuar gjykatës aprovimin padisë dhe detyrimin e të paditurës që të bëjë pagesën e shpenzimeve të ushqimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, C.nr.104/22 të datës 30.08.2024, me të cilin e ka detyruar të paditurën, që të përgjigjet në padi, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 06.09.2024, duke e njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënien e përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë, provat materiale, në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mos bindjes, ka gjetur se në rastin konkret, plotësohen të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë, nga neni 150 par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh se: *“Nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështet kërkesëpadia, nuk janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vet paditësi, apo me faktet e ditura botërisht”*.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka lexuar kontratën Nr.13/586-16 e dt. 01.09.2016, Vërtetimin Nr.66/22 e dt. 31.01.2022, Lista e pagave në emër të paditëses.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se:

Kërkesëpadia e paditëses është **e bazuar** nga arsyet e cekura si më poshtë:

Nga Listat e pagave në emër të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro.

Nga Kontratat e punës në emër të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura në kohë të pacaktuar dhe me kontratë I.

Nga administrimi i Vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “Sh. Sh.” në Ll. Nr.68/2022 e datës 31.01.2022, gjykata vërteton se paditësja V. R. nga data 01.06.2021 deri më 31.12.2021 ka punuar në këtë shkollë 52 ditë.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura në cilësinë e mësimdhënësës (fakt i vërtetuar edhe nga kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar Nr.13/586-16 dt. 01.09.2016 dhe vërtetimi me nr. 66/22 dt.31.01.2022); nuk

është kontestues fakti se e njëjta është me kualifikim shkollor Fakultet (fakti vërtetuar nga diploma bachelor); paga bazë e saj është 421.00 euro, si dhe fakti që e njëjta nga data 01.06.2021 e deri me datën 31.12.2021 ka gjithsejtë 52 ditë pune (fakt i vërtetuar në bazë të Vërtetimit Nr.66/2022 të dt. 31.01.2022).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, prova në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjithashtu sa i përket të drejtës për pagesë e shujtave, në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 (dhe asaj pasuese e datës 22.01.2021) me të cilën është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’u bërë kompensimin”*. Së këndejmi, rezulton se punëdhënësi i paditëses është e paditura në këtë rast, Komuna e Dragashit, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Ndërsa, sipas nenit 2 par. 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë shprehimisht precizohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*. Andaj, mbi bazën e kësaj që u paraqit, sipas raportit juridik të paditëses me të paditurën, këtë të fundit e bën plotësisht legjitime dhe me kompetencë për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, e as gjendjen faktike, por vetëm bazën e kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditësit e aprovuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se *“I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*; nenit 90, paragrafi 5 se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënësit dhe punëmarrësit të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dates 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se *“I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”*;

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017– 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Ndërsa sa i përket vlerësimit rreth shujtave gjykata ka vlerësuar se nga data 01.06.2021 – 31.12.2021 sa edhe ka qenë kërkesa e paditëses për ditët e pranisë në punë, për gjithsejtë 52 ditë pune nga dy (2) euro për një ditë, t’i paguaj shumën prej 104.00 euro për shujta dhe si i tillë një vlerësim për gjykatën ka qenë i thjeshtë dhe për këtë arsye edhe nuk ka angazhuar ekspertizë përkatëse financiare duke synuar parasëgjithash ekonomizimin e procedurës.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.
Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, për përpilimin e padisë shumë 78.00 euro dhe për taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 euro apo shumë totale prej 98.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, parag.1 lidhur me nenin 150 parag.1, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:145277, 15.10.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.